



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body

Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0243

Data: 05.07.2023

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Agon Ramadani-Referues dhe Vedat Poterqoi-Anëtar duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "U-Unique" Sh.P.K. kundër Njoftimit për Kontratë të datës 27.03.2023 i korrigjuar/ndryshuar me datën 13.04.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjilanit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në Rr. Adem Jashari" me numër të prokurimit 651-23-2715-5-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 05.07.2023 merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "U-Unique" Sh.P.K. me nr. 2023/0243 e datës 28.04.2023 kundër Njoftimit për Kontratë të datës 27.03.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjilanit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në Rr. Adem Jashari" me numër të prokurimit 651-23-2715-5-2-1.
2. Detyrohet Autoriteti Kontraktues që të përmisoj paramasën dhe parallogarinë e dosjes së tenderit nga Njoftimi për Kontratë i datës 27.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit duke marrë parasysh të gjeturat në arsyetimin e këtij vendimi si dhe të bëj zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave në përputhje me LPP.
3. Obligohet Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjilanit për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrij kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrihet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 27.03.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në Rr. Adem Jashari” me numër të prokurimit 651-23-2715-5-2-1. Procedura në këtë rast është e hapur ndërsa lloji i kontratës është punë ndërtimi me vlerë të parashikuar të kontratës 187,049.13 €. Bazuar në Njoftimin për Kontratë afati i fundit për pranimin e tenderëve ka qenë data 07.04.2023 në ora 14:30.

Me 03.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Formularin Standard për Korrigjimin mbi Njoftimet e Publikuara përmes të cilit është përcaktuar se afati i fundit për pranimin e tenderëve ka qenë data 18.04.2023 ora 14:30.

Me 31.03.2023 operatori ekonomik ankues "U-Unique" Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë B05 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 04.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues ashtu dhe ka vendosur të bëjë korrigjimin e dosjes së tenderit në harmoni me LPP si dhe të vazhdojë me këtë aktivitet të prokurimit. Kështu që me datë 04.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar edhe Formularin Standard për Korrigjimin mbi Njoftimet e Publikuara B54.

Me 13.04.2023 Ankuesi sërish ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë B05 të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Ndërsa me datë 20.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues ashtu që ka vendosur të bëjë sërish korrigjimin e dosjes së tenderit në harmoni me LPP si dhe të vazhdojë me këtë aktivitet të prokurimit. Kështu që me datë 20.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar edhe Formularin Standard për Korrigjimin mbi Njoftimet e Publikuara B54.

Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 20.04.2023, operatori ekonomik ankues me datë 28.04.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me Nr. prot. 2023/0243.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I)** - *“Për dallim nga paramasa paraprake ku përshkrimi i punëve në pozicione ishte përshkruar në mënyrë të qartë dhe të detajuar, në paramasën e korrigjuar (të gjitha pozicionet) përshkrimi i punëve nuk i përmban informatat relevante për punët që kërkojnë të realizohen pasi që është i mangët, i paqartë, dhe jo i plotë. Në këtë mënyrë është e pamundur që të përcaktohet oferta e saktë financiare për llojin e punës për shkak se nuk dihet çfarë pune konkrete duhet të kryhet dhe materiali që duhet të përdoret për shkak se mungojnë informatat e sakta, konkrete dhe specifike për secilin pozicion.*

Këto pasqyrohen pasqyrohen duke ju referuar përshkrimit të paramasës në disa nga pozicionet si më poshtë:

- 1. Në pozicionet nga 1 deri në 3, për elementet dhe punët elektrike, përshkrimi është: “elemente për tokëzim”. Mungon përshkrimi i saktë i punës dhe furnizimit: i specifikacioneve të elementeve të tokëzimit, i furnizimit të materilait të caktuar, furnizimi me sonda për tokëzim, duke përfshirë edhe materialin kryesor dhe të imët si dhe puna për vendosjen në hapësirën e caktuar sipas projektit.*
- 2. Në pozicionet nga 4 deri në 10, përshkrimi është: “punët ndërtimore: kanali kabllorik”. Mungon përshkrimi i saktë i punës dhe furnizimit: hapja – thellësia dhe ndërtimi i kanalit, përshkrimi i tipit të kanalit psh. K-31; transporti i dheut gjer në deponi; vendosja e kabllorëve; furnizimi dhe shtrirja e rërës (fraksioni) pasi janë vendosur kabllot; furnizimi dhe mbushja e kanalit me zhavor; furnizimi dhe vendosja e mbrojtësve mekanik dhe lloji i tyre; ngjeshja e shtresave të zhavorit, etj;*
- 3. Në pozicionet nga 11 deri në 13 dhe pozicioni 16 përshkrimi është: “puseta”. Mungon përshkrimi i saktë i punës dhe furnizimit: gjurmimi i dheut dhe transporti deri në deponi të mbeturinave; furnizimi me dërrasa si dhe rregullimi i mureve dhe pllakës së pusetave; furnizimi me material dhe furnizimi i pusetave me dimensionet ...; furnizimi dhe vendosja e armaturës me dimensione... dhe rrjetë ...; rregulimi i shkallëve që duhet të vendosen në pusetë; kapaku dhe korniza masive e pusetës nga metali, etj*
- 4. Në pozicionet nga 14 deri në 15 dhe 18 deri në 25, përshkrimi është: “punë të tjera ndërtimore”. Mungon përshkrimi i saktë i punës: cilat janë ato punë ndërtimore tjera që janë të nevojshme për realizimin e projektit*
- 5. Në pozicionin nr. 17 përshkrimi është: “punë ndërtimore - beton”. Mungon përshkrimi i saktë i punës dhe furnizimit: cilat janë ato punë ndërtimore tjera që janë të nevojshme për realizimin e projektit dhe çfarë betoni – klasa e betonit.*
- 6. Në pozicionet nga 26 deri në 29, përshkrimi është: “punë ndërtimore – gypa të betonit”. Mungon përshkrimi i saktë i punës dhe furnizimit: cilat janë ato punë ndërtimore dhe specifikat e gypave të betonit, diametri (gjatësia, gjerësia), etj*
- 7. Në pozicionet nga 30 deri në 32, përshkrimi është: “punë ndërtimore – gypa PE”. Mungon përshkrimi i saktë i punës dhe furnizimit: cilat janë ato punë ndërtimore dhe specifikat e gypave të betonit, diametri i tyre, etj*

Po ashtu për dallim nga paramasat standarde që i kanë dy kolona lidhur me përshkrimin e çmimit për njësi me TVSH dhe vlerës totale me TVSH, verzioni i paramasës në fjalë i ka gjithsej gjashtë (6) kolona për përshkrimin e çmimit. Për më tepër në pjesën e sipërme të paramasës janë dhënë disa sqarime sa që të paarsyeshme aq edhe të pakuptimta, si psh. thuhet referoju kolonave F, G e në fakt këto të klasifikuara me shkronja janë vetëm të supozuara, ndërsa tutje duke ju referuar supozimit për kolonën F lidhur me udhëzimet në shënimit të çmimit të ofertuar janë paraqitur kërkesa që bien në kundërshtim me nenin 17.11 të RRPP Nr. 001/2022”.

- **Pretendimi i dytë (II)** - *“Vlera e parashikuar për realizimin e kontratës në shumën prej 187,049.13€ paraqet pasqyrim të gabuar të analizës financiare dhe gjendjes faktike në krahasim me çmimet aktuale të tregut lidhur me objektin e kontratës në fjalë duke përfshirë edhe çmimet referente dhe çmimet e kontratave të natyrës së tillë të punës... Duke ju referuar analizimit të vlerës aktuale të tregut dhe metodës së kostos për realizimin e projektit në fjalë bazuar në çmimet e tregut aktual, konsiston se vlera totale për realizimin e projektit me sukses dhe që mos të dështojë është rreth apo mbi 300,000.00€”.*
- **Pretendimi i tretë (III)** - *“Sipas vendimit të AK-së i dt. 20.04.2023, nuk janë dhënë sqarimet relevante, respektivisht nuk na është siguruar e as nuk është publikuar në e-prokurimi deklarata e disponueshmërisë së fondeve, bazuar në pretendimet e paraqitura për shkak të ky aktivitet nuk është pjesë e planifikimit të prokurimeve për vitin 2023”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 paragrafin 1 dhe 2 lidhur me nenin 7 paragrafët 2, 3 dhe 6 pika (iii) të LPP, pastaj nenin 17 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (“RRPP”) në pikat 8, 11, 12 dhe 17 lidhur me nenin 27 të LPP, si dhe nenin 13 të RRPP në pikën 1 lidhur me nenin 9 paragrafin 1 dhe nenin 18 të LPP.

Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet ankesa ashtu që të detyrohet Autoriteti Kontraktues për të bërë korigjimet e nevojshme në njoftimin për kontratë ose për të anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit nëse shkeljet e pretenduara ligjore nuk mund të rregullohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka gjetur se ankesa është parashtruar brenda afatit ligjor dhe në përputhje me nenin 109 lidhur me nenin 108/A të LPP. Po ashtu është konfirmuar se Paneli Shqyrtues në OSHP ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankues në kuptim të nenit 105 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 13.05.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim”.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues dhe operatori ekonomik ankues nuk kanë shfrytëzuar të drejtën për të paraqitur mendimin e tyre lidhur me raportin e ekspertit.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor: në raportin e ekspertizës, eksperti shqyrtues ka konstatuar se *“përshkrimi teknik i llojeve (aktiviteteve) të punës në paramasën dhe parallogarinë respektivisht në përshkrimin e çmimit - versioni i korrigjuar i datës 20.04.2023, nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit... Andaj përshkrimi i çmimit (paramasa dhe parallogaria pothuajse në të gjitha pozicionet (te shtylla - llojet e punës) nuk e përshkruan aktivitetin e punës në mënyrë të saktë se cili lloj i aktivitetit do të kryhet, lloji i materiali që do të përdoret, instalimi - vendosja në vepër, testimi etj. Në këtë mënyrë gjatë ofrimit të çmimit në ofertë krijohen mundësi të interpretimit të ndryshëm. Psh. për poz. nr. 1 - lloji i punës është përshkruar: “Punët elektrike: elemente për tokëzim”. Ky përshkrim i këtij pozicioni nuk përmban përshkrimin e materialit i cili do të përdoret për tokëzim (llojin e materialit që do të përdoret për tokëzim, dimensionin e materialit, etj) është përseritur në disa raste ashtu siq janë edhe disa pozicione tjera. Ky përshkrim i mungon secilit pozicion në paramasë dhe në parallogari. Prandaj eksperti shqyrtues rekomandon që Autoriteti Kontraktues në bazë të nenit 11 të RRPP duhet të përgatit paramasën dhe parallogarinë në mënyrë që të përcaktohet sa më saktë aktiviteti i cili duhet të kryhet, pajisjet, materiali që do të përdoret, mënyra e testimit si dhe mënyra e pranimit të punimeve për secilin lloj të punës nga poz. nr. 1 deri nr. 32. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar”.*

Autoriteti Kontraktues nuk ka dërguar asnjë mendim lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Prandaj Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e parë ankimor i ka falur besimin e plotë konstatimeve si më sipër të ekspertit shqyrtues. Vlen të theksohet se konstatimi i ekspertit shqyrtues është elaboruar në mënyrë të detajuar përmes argumenteve të matshme, të ligjshme, logjike dhe mjaft bindëse. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor: në raportin e ekspertizës, eksperti shqyrtues ka konstatuar se *“vlera e parashikuar e kontratës është detyrë e Njesisë së Kërkesës në bazë të nenit 10 pikës b të RRPP. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar”.* Autoriteti Kontraktues nuk ka dërguar asnjë mendim lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Prandaj Paneli Shqyrtues edhe sa i përket pretendimit të dytë ankimor, sërish i ka falur besimin e plotë konstatimeve si më sipër të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë ankimor është i bazuar pjesërisht dhe atë vetëm në pjesën ku argumentohet se rritja e inflacionit ka mundur të ndikoj edhe në rritjen e çmimeve për produktet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate të prokurimit por jo edhe në pjesën e pretendimit ku operatori ekonomik ankues nuk arrin që të bëjë ndërlidhjen e drejtpërdrejtë në mes të gjendjes

faktike të pretenduar dhe të aktivitetit të prokurimit për të cilin bëhet fjalë, andaj Paneli Shqyrtues duke u nisur nga fakti se është vendosur që të shtyhet afati për dorëzimin e ofertave dhe përmasimin e dosjes së tenderit obligon AK që të rishikoj dhe të bëjë një hulumtim të tregut konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 13 të Rregullorës për prokurim publik.

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor: në raportin e ekspertizës, eksperti shqyrtues ka konstatuar se me datë 14.03.2023 Autoriteti Kontraktues përmes njësisë kërkuese ka parashtruar kërkesën për iniciimin e aktivitetin përkatës të prokurimit të cilës kërkesë ndër të tjera i ka bashkangjitur edhe “*Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve të datës 14.03.2023 me nr. të brendshëm GL 651 22 000 000 si dhe me arsyetim pse nuk është përfshirë në planin e prokurimit e cila deklaratë është e nënshkruar nga personi kërkues me datën 14.03.2023, Zyrtari Kryesor Financiar me datën 16.03.2023 si dhe nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar*”.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dërguar asnjë mendim lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Prandaj Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e tretë ankimor i ka falur besimin e plotë konstatimeve si më sipër të ekspertit shqyrtues. Vlen të theksohet se konstatimi i ekspertit shqyrtues është elaboruar në mënyrë të detajuar përmes argumenteve të matshme, të ligjshme, logjike dhe mjaft bindëse. Përndryshe kjo gjendje faktike si e tillë mund të konfirmohet edhe përmes dokumenteve dhe shkresave përbërëse të dosjes së tenderit konkretisht *Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve të datës 14.03.2023 me nr. të brendshëm GL 651 22 000 000*. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i tretë ankimor është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht Pjesës II të Kontratës – Kushtet e Përgjithshme ku përmes nenit 25 paragrafit 25.1 përcaktohet se “*Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit*”. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se Autoriteti Kontraktues në asnjërin prej pozicioneve në paramasë dhe paralogari nuk ka arritur që të përshkruaj në mënyrë të saktë llojin e aktivitetit që do të kryhet, llojin e materialit që do të përdoret, instalimi - vendosja në vepër, testimi etj. Në këtë mënyrë gjatë ofrimit të çmimit në ofertë krijohen dykuptimësi dhe mundësi të interpretimit të ndryshëm. Psh. për poz. nr. 1 - lloji i punës është përshkruar: “Punët elektrike: elemente për tokëzim”. Ky përshkrim i këtij pozicioni nuk përmban përshkrimin e materialit i cili do të përdoret për tokëzim (llojin e materialit që do të përdoret për tokëzim, dimensionin e materialit, etj). Ky përshkrim i mungon secilit pozicion në paramasë dhe në paralogari. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues e përkrah

rekomandimin e ekspertit shqyrtues ku thuhet që *“Autoriteti Kontraktues në bazë të nenit 11 të RRPP duhet të përgatit paramasën dhe paralogarinë në mënyrë që të përcaktohet sa me saktë aktiviteti i cili duhet të kryhet, pajisjet, materiali që do të përdoret, mënyra e testimi si dhe mënyra e pranimit të punimeve për secilin lloj të punës nga poz. nr. 1 deri nr. 32”*.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të detyruar Autoritetin Kontraktues që të përmisoj paramasën dhe paralogarinë e dosjes së tenderit nga Njoftimi për Kontratë i datës 27.03.2023 duke marrë parasysh të gjeturat si më sipër në arsyetimin e këtij vendimi. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë edhe zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vjosa GRADINAJ
Kryetare e Panelit Shqyrtues

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtoj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.